



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH**

Gramsh 21/01/2026

Nr 195/2 prot

V E N D I M

Nr 4 dt. 21.01 .2026


**PER
DESTINIMIN E FONDIT TË GRANDIT TË BAZUAR NË PERFORMANCE.**

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës __.01.2026 , pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë “Për destinimin e fondit të grandit të bazuar në performancë, mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” kreu 8 nenet 34-41, në ligjin Nr .68 /2017” Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025 aneksit 9 "Granti i Performancës ", të Udhëzimit të Ministrit të financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr. 1031/5, datë 11.07.2025, dhe nr. 10725, date 11.07.2025, "Per kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025".

V E N D O S I

- I. Të destinohet fondi i grandit të bazuar në performancë me burim financimin e huaj në vlerën 6,111,012.53 lekë për financimin e pjesës së bashkëfinancimit të marëveshjes së nënshkruar ndërmjet Islamic Relief Worldwide- Zyra në Shqipëri (IRA) dhe Bashkisë Gramsh me objekt “Ndërtimin e 7 ambulancave tip A1/A2, furnizimin e tyre me mobilje esenciale dhe rindërtimin e një ujësjellësi” me vlerë të përgjithshme 41,967,931 lekë dhe pjesa bashkëfinancimit nga bashkia në vlerën 12,590,377 lekë:
- II. Destinimi i fondi të grandit të bazuar në performancë me burim nga buxheti i shtetit të destinohet në mbledhjen e radhës me të ardhurat e trashëguara të vitit 2025.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretari i Keshillit
Xhulia Gjini**



**Kryetari i Këshillit Bashkiak
Enis Zani**